



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1284 Prot.

Durrës, më 13.05.2025

VENDIM

Nr. 47, datë 13.05.2025

PËR

"NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 17, DATË 01.11.2024 PËR "MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE DOKTORATË NË "DIDAKTIKË E GJUHËVE TË HUAJA" PRANË DEPARTAMENTIT TË GJUHËVE TË HUAJA, NË FAKULTETIN E EDUKIMIT, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës", ME UNIVERSITETIN "CONSTANTINE THE PHILOSOPHER UNIVERSITY" NITRA, SLOVAKI"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, pika 3 e kreut IV/A; në Rregulloren dhe Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; Vendimin e Senatit Akademik Nr. 17, datë 01.11.2024; Vendimin e Senatit Akademik Nr. 56, datë 17.12.2024 si dhe në relacionin e Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 1270/1 prot., datë 13.05.2025, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e cilësimeve për programin e përbashkët (diplomë e dyfishtë) të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" në "Didaktikë e Gjuhëve të Huaja", pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja, në Fakultetin e Edukimit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu"

Durrës me Universitetin "Constantine the Philosopher University" Nitra, Slovaki, si më poshtë:

- a) Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën angleze;
 - b) Kodi i programit të studimit: **P83DO0231A**.
2. Ky vendim i bashkëlidhet Vendimit Nr. 17, datë 01.11.2024 dhe Vendimit Nr. 56, datë 17.12.2024.
 3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për saktësimet përkatëse.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

